

1. Informacion i përgjithshëm

Digicom Sh.p.k ("Shoqëria") është krijuar më datën 18/08/2014. Shoqëria është regjistruar në autoritetet tatimore me Numër Identifikimi të Personit të Tatueshëm (NIPT) L42018012R.

Kuotat e Shoqërisë zotërohen 85% nga Shoqëria Info-Telecom dhe 15% nga Z. Marin Gjonaj.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është ndërtim rrjetesh telekomunikacioni dhe ofrimi i shërbimeve të telekomunikacionit, internetit, telefonisë fikse, televizion me pagesë, etj. nëpërmjet sistemeve të fibrave optike.

Administrator i shoqërisë është Z. Thoma Zbogo.

Më 31 Dhjetor 2018 shoqëria kishte 145 punonjës (2017: 144 punonjës).

Selia e shoqërisë është te Njësia Bashkiake nr.2, Rruga Dervish Hima, Pallati Ada Toëer, nr.1, Kati përdhe.

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë dhe bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të zbatuara në Shqipëri në saj të Ligjit nr.9228 datë 29 Prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, dhe të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe Ministria e Financave.

Sipas SKK 11 "Mbi Tatim Fitimin", paragrafi 4, Shoqëria ka zgjedhur të mos kontabilizoj tatimet e shtyra në pasqyrat financiare për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2018.

Drejtimi ka përgatitur pasqyrat financiare në bazë të parimit të vijimësisë. Në marrjen e këtij vendimi, drejtimi mori në konsideratë planet e biznesit të shoqërisë, përfshirë këtu parashikimet e fitimit dhe mjeteve monetare si edhe ecurinë aktuale.

Këto pasqyra financiare paraqiten në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë, monedha e ambientit ekonomik kryesor në të cilin shoqëria kryen aktivitetin e saj.

2.2. Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të ushtrojë gjykim në procesin e vlerësimeve dhe supozimeve që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumëve të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet përkatëse rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken nga këto rishikime.

Në veçanti, informacioni në lidhje me fushat më të rëndësishme të vlerësimeve, pasigurisë dhe gjykimeve në zbatimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të konsiderueshme ndaj



shumave të njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare.

2.3. Instrumente financiarë

Instrumentet financiarë jo-derivativë përbehen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentet financiarë jo-derivativë njihen nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet.

blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, e cila është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjete monetare dhe ekuivalentë

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtra me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit të tyre. Mjetet monetare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me koston të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme për llogaritë kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha të drejtat sipas kushteve fillestare të tyre. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitorit të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme janë të mbivlerësuara. Shuma e provizionit llogaritë si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikura monetare të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme njihen me vlerë të drejtë dhe maten më pas me koston të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huamarrjet

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerë të drejtë dhe maten më pas me koston të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Të tjera

Instrumente të tjerë financiar jo-derivativë maten me koston të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.



Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar, huave, përafrohet me vlerat e tyre kontabël.

2.4. Aktivet afatgjata materiale dhe jo-materiale

Aktivët afatgjata materiale dhe jo-materiale janë pasqyruar në librat e shoqërisë me koston e tyre historike minus zhvlerësimin e akumuluar.

(i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivët afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar, nëse ka të tilla.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit mbarten nën aktive afatgjata jo-materiale dhe aktive financiare dhe kapitalizohen dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur zbatohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët me të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve jo-materiale dhe përmirësimit të ambienteve llogaritet duke përdorur metodën lineare të amortizimit dhe duke përdorur metodën e vlerës së mbetur për të gjitha aktivët e tjera afatgjata mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason mujin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Toka nuk amortizohet.

Normat vjetore të zhvlerësimit të aplikuara janë si më poshtë:

	Norma e zhvlerësimit %	Baza e llogaritjes
Aktive afatgjata materiale		
Ndërtesa	5	Vlera kontabël neto
Makineri dhe pajisje	20	Vlera kontabël neto
Mobileri dhe orendi	20	Vlera kontabël neto
Pajisje elektronike	25	Vlera kontabël neto
Aktive afatgjata jo-materiale		
Programe kompjuterike	25	Vlera kontabël neto
Të tjera aktive jo-materiale	15	Kosto

Vlera kontabël e aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale rishikohet për rënie në vlerë kur ndyshimet e rrethanave tregojnë që vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse rrethana të tilla ekzistojnë dhe kur vlera kontabël tejkalon vlerën netë të realizueshme, aktivet ose njësitë gjeneruese të parasë do të pakësohen në vlerën e tyre të realizueshme dhe humbjet nga rënia e vlerës njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

2.5. Aktivet dhe detyrimet financiare

Aktivitet dhe detyrimet financiare konsistojnë tërësisht në llogari të arkëtueshme dhe llogari të pagueshme dhe janë pasqyruar në bilanc bazuar në shumat e faturuara.

Provizionet për borxhet e këqija njihen kur shumat konsiderohen të pambledhshme. Provizionet për borxhet e këqija është vlera e llogaritur nga drejtimi për absorbuar humbje të mundshme në të ardhmen për llogari të arkëtueshme eksituese që mund të bëhen të pambledhshme si pasojë e kushteve ekonomike ekzistuese, rreziqeve të qenësishme dhe cilësisë së klientëve dhe faktorëve të tjerë relevant, që sigurojnë njohjen aktuale. Vlera e humbjeve specifikisht e identifikuar (p.sh. klientë të klasifikuar si të dyshimtë dhe të humbur) njihen si shpenzime dhe zbriten nga totali i llogarisë së arkëtueshme për atë klient si provizion për borxhet e këqija.

2.6. Zhvlerësimi

(i) Aktivitet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave

dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshën për shitje i njohur më parë në kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Aktivet jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve.

2.7. Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse a pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

2.8. Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

2.9. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshinë tatimin e periudhës, i cili njihet drejtëpërdrejtë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës.

Tatim fitimi llogaritet me 15% për vitin 2018 mbi fitimin e tatueshëm.

2.10. Detyrime për sigurimet shoqërore

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore që sigurojnë pension për punonjësit. Qeveria shqiptare është përgjegjëse për caktimin e minimumit të kontributit për sigurimet shoqërore në Shqipëri sipas një plani pensioni bazuar në kontribute. Kontributet e shoqërisë në planin e pensionit janë pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave kur ndodhin.



2.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3. Vlerësimet e rëndësishme kontabël dhe supozimet

Në aplikimin e politikave kontabël të shoqërisë, që përshkruhen në Shënimin nr.2, nga drejtimi kërkohet që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime për vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve që nuk janë të qarta nga burime të tjera. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura me to janë të bazuara në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë që konsiderohen relevant. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet e lidhura me to janë rishikuar në mënyrë të vazhdueshme. Ndryshimet tek vlerësimet kontabël do të njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar n.q.s rishikimi afekton vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe në periudha të ardhshme n.q.s rishikimi ndikon periudhën aktuale dhe të ardhme.

Pasiguria në gjykime

Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Humbjet nga zhvlerësimi do të njihen në vlerën në të cilën vlera kontabël e aktiveve ose e njësisë gjeneruese të parasë tejkalojnë vlerën e rikuperueshme. Kur përcaktohet vlera e rikuperueshme, drejtimi vlerëson çmimet e pritshme dhe flukset e parasë nga çdo njësi gjeneruese të parasë dhe përcakton një normë interesi të përshtatshme kur kalkulohet vlera aktuale e këtyre flukseve parash.

Jeta e dobishme e aktiveve të amortizueshme.

Drejtimi i shoqërisë në mënyrë të rregullt analizon jetën e dobishme të aktiveve të amortizueshme në datën e pasqyrave financiare. Drejtimi vlerëson që jeta e dobishme e përcaktuar për aktivet paraqet dobishmërinë e pritshme të aktiveve.

Vlera kontabël e këtyre e këtyre aktiveve është analizuar në shënimet 9 dhe 10. Megjithatë, rezultatet faktike mund të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve teknologjike.

Inventari

Inventari është paraqitur me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës së realizueshme neto. Gjatë përcaktimit të verës së realizueshme neto, drejtimi merr parasysh evidencat me objektive/te dhënat e disponueshme për kryerjen e vlerësimeve.



4. Mjete monetare

Mjetet monetare janë si vijon:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Arka		
- në monedhe vendase	3,099,109	2,679,998
- në monedhe te huaj	298,345	90,683
	<u>3,397,454</u>	<u>2,770,681</u>
Llogari rrjedhëse në banka		
- në monedhe vendase	6,572,102	10,797,366
- në monedhe te huaj	4,536,249	10,449,025
	<u>11,108,351</u>	<u>21,246,391</u>
ATM	293,560	-
Paypal	343,419	566,298
Totali i mjeteve monetare	<u>15,142,784</u>	<u>24,583,370</u>

5. Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme janë detajuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Kliente Biznes	34,258,944	18,276,083
Klient Microbiznes	10,924,350	9,176,419
Kliente Rezidencial	24,313,514	18,756,239
Totali	<u>69,496,808</u>	<u>46,208,741</u>

Drejtimi i kompanisë nuk ka bërë provision për borxhin e keq.

6. Të tjera të drejta të arkëtueshme

Të tjera të arkëtueshme janë detajuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Parapagime per furnitore	3,048,605	846,351
Te drejta nga pale te lidhura	190,998	2,085,198
Shpenzime te periudhave te ardhshme	838,390	1,971,050
Llogari Dogane	24,503	136,735
Te tjera	691,844	-
Totali	<u>4,794,340</u>	<u>5,039,334</u>




7. Inventari

Inventari është pasqyruar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Materiale konsumi dhe të imta	168,661	27,083,080
Materiale promovionale	116,032	-
Parapagime për inventar	-	84,933
Totali	284,693	27,168,013

Në vitin 2017 është raportuar gabimisht si materiale konsumi dhe të imta shuma 27,050,813 lek. Keto material janë blerë me qëllim të paracaktuar për ndërtimin e rrjetit Digicom, prodhimin e aseteve për ofrimin e shërbimit ndaj klientëve të kompanisë. Referuar Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit dhe qëllimit të paracaktuar të këtyre materialve është bërë në vitin 2018 riklasifikimi i shumës 27,050,813 lek në Aktive Afatgjata Materiale.

8. Aktive afatgjata jomateriale

Aktivët afatgjata jomateriale janë analizuar si më poshtë:

	Aktive jomateriale	Aktive jomateriale në Proces	Total
Kosto Historike			
Ne 31 Dhjetor 2017	12,217,520	-	12,217,520
Shtesa	-	16,312,584	16,312,584
Pakesime	-	-	-
Transferime nga aktivet në proces	16,312,584	-16,312,584	-
Ne 31 Dhjetor 2018	28,530,104	-	28,530,104
Amortizimi I Akumuluar			
Ne 31 Dhjetor 2017	-2,271,986	-	-2,271,986
Amortizimi I Vitit	-2,888,453	-	-2,888,453
Pakesime	-	-	-
Ne 31 Dhjetor 2018	-5,160,439	-	-5,160,439
			-2,747,053
Vlera e Mbetur			
Ne 1 Janar 2018	9,945,534	-	9,945,534
Ne 31 Dhjetor 2018	23,369,665	-	23,369,665

9. Aktive afatgjata materiale

	Instalime të përgjithshme	Paisje zyre dhe informatike	Mjetet e Transporti	Aktive materiale në Proces	Total
Kosto Historike					
Ne 31 Dhjetor 2017	152,801,052	30,884,895	10,355,719	8,853,465	202,895,131
Rivleresim nga kontrolli tatumor	4,799,619				4,799,619
Ne 31 Dhjetor 2017	157,600,671	30,884,895	10,355,719	8,853,465	207,694,750
Shtesa	-	-	-	69,508,212	69,508,212
Pakesime	-3,377,341	-	-	-1,480,464	-4,857,805
Riklasifikim nga inventari 2017	-	-	-	27,050,813	27,050,813
Riklasifikim nga inventari 2018	-	-	-	9,366,971	9,366,971
Transferim midis rubrikave	13,345,862	-13,345,862	-	-	-
Transferime nga aktivet në proces	84,613,378	1,769,460	14,583	-86,397,421	-
Ne 31 Dhjetor 2018	252,182,570	19,308,493	10,370,302	26,901,576	308,762,941
Amortizimi I Akumuluar					
Ne 31 Dhjetor 2017	-21,907,968	-5,300,799	-3,065,941	-	-30,274,708
Amortizimi I Vitit	-20,898,452	-2,832,923	-1,459,186	-	-25,190,561
Pakesime	1,579,389	-	-	-	1,579,389
Ne 31 Dhjetor 2018	-41,227,031	-8,133,722	-4,525,127	-	-53,885,880
Vlera e Mbetur					
Ne 1 Janar 2018	135,692,703	25,584,096	7,289,778	8,853,465	177,420,042
Ne 31 Dhjetor 2018	210,955,539	11,174,771	5,845,175	26,901,576	254,877,061

Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale regjistrohën fillimisht si aktive në proces dhe më pas klasifikohen si aktive afatgjata materiale dhe jo materiale kur janë gati për përdorim.

10. Investime financiare afatgjata

Pjesëmarrjet e Digicom në shoqëri të lidhura të vlerësuara me kosto janë detajuar si më poshtë:

	Kuota %	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Investimi tek ADA Net shpk	100	100,000	100,000
Totali		100,000	100,000

Digicom ka blerë 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë ADA Net shpk më 06 Tetor 2014.

11. Llogari të pagueshme

Llogarit e pagueshme përfshijnë kryesisht detyrimet kundrejt furnitorëve të huaj dhe vendas.

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Furnitore te Huaj	177,725	834,806
Furnitore Vendas	127,174,925	61,642,899
Total	127,352,650	62,477,705

12. Detyrime të tjera rrjedhëse dhe të përlogaritura

Detyrimet për taksat dhe të tjera rrjedhëse janë të detajuara më poshtë:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Garanci per pajisje ne perdorim	20,994,374	17,120,840
Furnitore per fatura te pamberritura	135,916	-
Kosto Personeli	1,152,145	957,594
TVSH e pagueshme	1,273,058	114,050
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	2,019,646	1,919,189
Tatim ne burim dhe TAP	1,432,394	775,686
Tatim fitimi	210,895	113,807
	27,218,428	21,001,166

Shoqëria merr garanci nga klientët për të garantuar mbarëvajtjen e kontratës. Vlera e garancisë I kthehet klientit në momentin e mbylljes së kontratës.

13. Të ardhura të marra në avancë

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Të ardhura të periudhave të ardhshme	24,148,538	-
Kreditor për parapagime telefonie	2,205,318	-
Total	26,353,856	-

Të ardhurat e marra në avancë lidhen me pagesa të bëra kryesisht për kontrata nga një deri në dy vjet për shërbime internet dhe IPTV.

14. Huamarrje

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Titujt e huamarrjes nga:		
Ortaku Info-Telecom Shpk	199,667,870	204,745,483
Ortaku Marin Gjonaj	38,470,367	43,725,383
Total	238,138,237	248,470,866

15. Të ardhura

Shoqëria ofron shërbime interneti, telefoni dhe IPTV për individë dhe kompani. Të ardhurat janë analizuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Te ardhura nga shërbime telekomunikacioni brenda vendit	225,737,983	215,552,938
Te ardhura nga shërbime telekomunikacioni jashte vendit	3,642,020	20,187,866
Te tjera	7,937,565	11,342,663
Totali	237,317,568	247,083,467

16. Të ardhura të tjera

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Te ardhura nga shitja e aktiveve	6,140,985	1,615,642
Te tjera	212,987	232,896
Totali	6,353,972	1,848,538

17. Furnizim materiale, shërbime interneti dhe të tjera

Kosto e materialeve, kosto aksesi në internet dhe shpenzime të tjera direkte janë detajuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Kosto aksesi ne internet	22,400,204	21,375,124
Te drejta TV	4,460,762	1,136,905
Kosto telefonie	20,827,174	38,911,899
Qera dhe shpenzime utilitare	4,471,536	-
Riparime dhe mirembajtje	7,661,299	5,766,301
Blerje materiale	341,431	11,370,982
Te tjera	205,209	-
Kostoja e materialeve dhe shërbime interneti	60,367,615	78,561,211




18. Shpenzime personeli

Shpenzimet për personelin detajohen si vijon:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Paga dhe shpërblime	86,425,525	77,794,752
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	11,404,629	13,356,770
Totali	97,830,154	91,151,522

19. Shpenzime të tjera operative

Shpenzimet administrative dhe të tjera operative përbëhen nga:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Shpenzime utilitare dhe qera	12,953,209	7,507,702
Shpenzime marketingu	4,411,446	5,473,861
Shitje e aktiveve afatgjata	2,186,586	1,243,480
Tarifa dhe licenca	5,355,821	4,459,592
Sherbime profesionale dhe te tjera	21,972,286	1,841,686
Blerje materiale konsum administrativ	2,176,044	1,900,962
Komision shitje	4,525,017	4,421,546
Taksa te tjera	893,443	462,112
Komisione bankare	839,524	642,676
Trajnime dhe evente BNJ	599,293	776,051
Kosto transporti	2,385,108	8,471,047
Honorare	2,555,463	15,354,485
Te tjera	5,320,743	4,284,009
Totali	66,173,983	56,839,209

20. Situacione punimesh nevoja të brendshme

Të ardhura dhe shpenzime të tjera që lidhen me kapitalizimin e ndërtimeve që bëhen ngë rrjetin e brendshëm të telekomunikacionit nga shoqëria për nevojat e veta.

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Situacione rrjeti FO	20,239,584	30,017,452
Situacione Instalime	31,980,624	-
Situacione SITE	3,684,177	7,779,816
Situacione të tjera	14,838,314	-
Total	70,742,699	37,797,268




21. Të ardhura/(shpenzimet) financiare

Të ardhurat/(shpenzimet) financiare përfshijnë fitimet dhe humbjet e realizuara apo të porealizuara nga kurset e këmbimit, të ardhurat dhe shpenzimet nga interest dhe të tjera të ardhura financiare si vijon:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Shpenzime interesi	-22	-
Humbje nga kursi I këmbimit	-6,004,386	-9,413,828
Shpenzime Financiare:	-6,004,408	-9,413,828
Te ardhura nga interesi	1,149	11,931
Fitim nga kursi I këmbimit	5,356,455	18,787,751
Te ardhura Financiare:	5,357,604	18,799,682
Totali të ardhura/(shpenzime) financiare neto	-646,804	9,385,854

22. Shpenzimi I tatimit mbi fitimin

Shpenzimi I tatim fitimit rakordon me fitimin kontabël për vitet 2018 dhe 2017 si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
1 Fitimi/(Humbja) para tatimit	-9,426,030	10,867,192
2 Shpenzime te panjohura	10,006,615	6,439,763
Shpenzime te panjohura - Shtese nga		
3 Rivleresimi i kontrollit tatimor	-	865,300
4 Te ardhura te pa tatueshme	-	-
5 Fitimi / (humbje) e tatueshme (1+2+3+4)	580,585	18,172,255
4 Humbje te mbartura (-)	-	-17,013,541
5 Taxable profit/(loss)	580,585	1,158,714
6 Norma e tatimit mbi fitimin	15%	15%
7 Shpenzim tatim fitimi	87,088	173,807
8 Tatim fitimi i mbartur	113,807	-
9 Tatim fitimi I parapaguar	-	60,000
Tatim fitimi I paguar dhe perdorur per		
10 detyrime te tjera	10,000	
11 Tatim fitimi i pagushem (arketueshem)	210,895	113,807

23. Detyrime të kushtëzuara

Detyrime tatimore

Në zbatim të ligjit Nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, I ndryshuar, neni 80 deri 87, Digicom ka qënë subject Kontrolli Tatimor sipas “Njoftim Kontrolli Tatimor” nr.68435/1 prot, datë 23/10/2018 dhe autorizimit me nr 68435/1 prot, datë 05/12/2018, për Llojet e Tatimeve dhe periudhat si më poshtë:

Për Tvsh-në	09/2014 - 05/2018
Për Tatim Fitimin	2014 - 2017
Për Sigurimet Shoqërore & Shëndetësore	09/2014 - 05/2018
Të Tjera	Deri më 05/2018

Konkluzionet e këtij kontrolli tatimor, të parashtruara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë nëpërmjet “Njoftim Vlerësimit nr, 68435/5 prot, datë 18/03/2019 janë reflektuar në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018 dhe vitin para-ardhës të mbyllur më 31 Dhjetor 2017.

Çështje gjyqësore

Në datën e mbylljes së pasqyrave financiare 31 Dhjetor 2018, nuk ka asnjë çështje gjyqësore të ngritur kundër shoqërisë Digicom Shpk.

24. Ngjarje pas datës së raportimit

Mbas datës 31 Dhjetor 2018 – datë e raportimit dhe aprovimit të pasqyrave financiare, nuk ka ngjarje materialisht të rëndësishme që mund të ndikojnë në këto pasqyra financiare.



Pasqyra e TVSH dhe rakordimi me te dhënat kontabel

Muaji	BULEJDE										SHTETI			
	Te pajantuar, m e TVsh jo te abritshme pa TVSH	Blloje investime brenda vendit pa TVSH	Importe mallra me shkakit 20%	Importa te investimit me shkakit 20%	Te investimit nga Furnitoria Vendea me shkakit 20%	Nga Furnitoria Vendea me shkakit 20%	To investimit nga Furnitoria Vendea me shkakit 20%	Autongarkesa TVSH ne Blloje	Shifra pa TVSH	Eksporte mallrash	Shifte me shkakit 20%	Autongarkesa TVSH ne shifte	TVSH E PAGUAR	
	Vlera e Tatueshme	Vlera e Tatueshme	Vlera e Tatueshme	Vlera e Tatueshme	Vlera e Tatueshme	Vlera e Tatueshme	Vl. Tatuesh	Zotimesho		Vlera e Tatueshme	Vlera e Tatueshme			
Janar	2,958,178	-	131,640	-	203,162,947	4,152,520	1,018,883	203,713	1,631,455	21,103,209	4,220,769	203,772		
Shkurt	2,646,060	-	5,164,993	-	5,594,058	1,318,812	947,300	109,470	1,278,074	10,362,945	3,872,509	168,476		
Mars	4,993,622	-	-	-	3,308,028	1,018,806	1,803,583	372,717	1,100,814	10,784,071	3,956,814	608,406		
Prill	762,026	-	-	-	3,307,813	661,563	2,646,250	405,940	756,053	19,405,219	3,893,044	81,048		
Maji	3,533,713	-	-	-	13,388,812	2,877,762	363,622	984,425	1,089,804	19,253,504	3,850,707	78,829		
Qersh	1,401,480	-	-	-	22,207,529	4,441,526	301,606	444,600	841,879	38,250,706	7,846,141	68,900		
Korrik	2,011,570	-	-	-	9,117,113	1,853,421	2,985,156	308,112	420,416	29,258,938	4,459,368	77,222		
Gusht	1,097,000	-	-	-	10,346,039	2,077,168	210,760	1,103,872	490,504	24,967,413	4,973,483	2,302,630		
Shtator	2,262,322	-	-	-	39,496,176	7,699,835	692,021	1,827,153	914,893	55,533,830	11,000,766	36,431		
Tor	2,262,322	-	-	-	5,657,354	731,467	1,699,761	155,784	1,578,486	20,232,170	5,640,436	31,157		
Nentor	2,018,240	-	-	-	8,957,425	1,763,485	12,348,907	2,409,781	1,430,210	27,210,952	5,442,140	63,257		
Dhjetor	2,018,240	-	-	-	12,010,144	2,402,029	17,234,056	3,446,031	61,216	34,818,823	6,923,705	57,086		
Totali	26,030,298	333,600	6,236,205	9,247,009	107,492,118	31,408,424	38,420,225	7,620,405	9,633,343	1,421,817	331,160,118	1,608,700		

TVSH per te paguar Janar 2019
as per TB
DT

Rivlerimin
situate nga
kontrolli
balmor

Kuestioni i abilitimit me sistemin FS dhe PASH

Shprehja	Komunitete
Te ardhura ne total	243,871,540
Te ardhura te tatuarat ne 2016 qe merrtohen	24,146,538
Audituarimi (Reverse charge)	5,443,899
Faullimi nga Subjekti te Situacioneve par ne	70,742,899
Çerçenit Pajise te tatuarat 480	3,873,300
Parapajise per Voip	1,468,406
Detyrime furnitoresh te politeruara te cilit ja	(1,228,310)
Riferencat te ardhura nga kontrolli balmor	(158,926)
Totali	357,653,776

31 Dhjetor 2019

Te ardhura nga	225,737,983
Te ardhura nga	3,042,000
Te tjera	7,607,565
Totali	236,387,548
Sikex PASH	237,317,560
DT	247,353,467

31 Dhjetor 2017

Te ardhura nga	215,562,493
Te ardhura nga	20,187,868
Te tjera	11,342,663
Totali	247,093,024
DT	247,353,467

DT /mm



[Handwritten signature]

Pasqyra e pagave dhe rakordimi me te dhenat kontabel

Shpenzime te personelit dhe sigurimet shoqerore

Nr	Muaji	Nr Punonjese	Paga bruto ne leke		11) Mbi te cilen illogariten kontributet	1				12) Gjithsej = (13+14+15)	15) Kontribut shtese	16) Kontribute per sigurimet shendetesore gjithsej ne	18) Tatimi mbi te ardhurat nga punesimi ne leke	Kapitalizim paga sipas situacionev e TAX	Kapitalizim honorare sipas situacioneve TAX
			10) Gjithsej	11) Mbi te cilen illogariten kontributet		Nga keto:									
1	Janar	148	7,568,964	6,852,260	1,936,266	1,027,587	650,925	-	257,754	505,423	1,593,708	220,538			
2	Shkurt	151	7,729,946	6,935,505	1,962,041	1,040,073	658,834	-	263,134	525,298	1,617,203	99,934			
3	Mars	152	7,696,836	7,082,579	1,991,863	1,059,134	670,909	-	261,820	494,028	1,602,080	164,266			
4	Prill	150	7,518,982	6,906,003	1,940,040	1,031,146	653,186	-	255,708	493,311	1,612,320	133,414			
5	Maj	141	8,878,171	6,915,722	1,970,087	1,021,228	646,903	-	301,956	813,408	1,503,657	139,824			
6	Qershor	137	8,805,742	6,842,370	1,949,625	1,010,225	639,938	-	299,462	817,549	1,473,232	120,882			
7	Korrik	146	8,879,100	6,939,728	1,970,160	1,021,299	646,906	-	301,955	818,489	1,419,043	122,087			
8	Gusht	143	8,847,610	6,894,392	1,963,848	1,017,769	644,851	-	301,228	814,878	1,353,371	9,569,676			
9	Shtator	144	8,784,524	6,808,414	1,940,591	1,005,134	636,716	-	298,741	809,870	1,536,731	841,570			
10	Tetor	145	8,930,120	6,841,416	1,953,619	1,010,082	639,848	-	303,689	830,272	1,471,381	1,732,071			
11	Nentor	145	9,170,913	6,795,121	1,950,464	1,003,137	635,448	-	311,879	886,016	1,581,965	1,661,814			
12	Dhjetor	145	9,466,620	7,034,593	2,019,646	1,039,057	658,199	-	322,390	916,112	1,708,413	1,933,742			
	TOTALI		102,277,528	82,828,103	23,548,250	12,285,871	7,782,663	-	3,479,716	8,724,654	18,473,104	16,739,818			

Kuadrimi i situates me sistemin

Sipas sistemit	Paga Shpenzime	Sig detyrim	TAP detyrim
Faturim nga Subjekti te Situacioneve per ndertim aktivi aftaigjate (Kapitalizim Paga)	97,830,154	-2,019,646	-916,112
Shperblime semundje dhe falkeqesi	18,473,104	2,019,646	916,112
Sig. Shoqerore te paguara nga punemarresi	-	0 imm	0 imm
Sipas Listepageses	116,303,257	ok	ok

Dif - imm ok



(Handwritten signature)